

FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS



STATUT

I

FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

Prishtinë, Prill 2018



Në bazë të ligjit Nr. 04/L-57 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare të Kosovës të datës 09.09.2011 dhe në bazë Ligjit 04/L-075 për ndryshimin dhe plotsimin e ligjit Nr. 2003/24 për Sport të datës 20.01.2012, nenit 27, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit të Federatës Atletike të Kosovë, më 24.02.2018 aprovoi këtë:

STATUT TË FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Federata Atletike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: FAK) është asociacion sportiv i organizatave sportive e përkushtuar për zhvillimin dhe përparimin e sportit të atletikës në Republikën e Kosovës, si dhe arritjen e qëllimeve dhe interesave të saja në përputhje me ligjin e sportit, aktet normative të IAAF-së dhe këtë statut.

Neni 2.

Federata Atletike e Kosovës është themeluar në kuvendin themelues me 21 shtator të vitit 1991 në Prishtinë. Fushëveprimtaria e saj shtrihet në territorin e Republikës së Kosovës.

Federatën Atletike të Kosovës e përbëjnë antarët e saj të pranuar sipas këtij statuti dhe rregulloreve në fuqi (në tekstin e mëtejme anëtarët e Federatës), të cilat merren me të gjitha format e organizimit të aktiviteteve sportive amatore apo profesionale.

Marrëdhëniet në Federatën Atletike të Kosovës janë të bazuara në parimet e drejtësisë, barazisë dhe bashkësisë së organizatave sportive, të cekur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 3.

Federata Atletike e Kosovës është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Federatave Atletike (IAAF), Shoqatës Evropiane të Atletikës (EAA), Unioni Mediteran i Atletikës (MUA), Shoqatës i Atletikës së Ballkanit (ABAF) dhe Komitetit Olimpik të Kosovës. Federata Atletike e Kosovës mund të anëtarësohet edhe në organizata tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë në interes të sportit të atletikës në Kosovë.

Punën e saj FAK e orienton mbi bazën e respektimit të rregullave dhe rregulloreve të këtyre organizatave.

Neni 4.

Federata Atletike e Kosovës funksionon si organizatë joprofitabile dhe jopolitike.

Neni 5.

Emri i Federatës është: Federata Atletike e Kosovës, kurse akronimi i saj është FAK.

Selia e Federatës Atletike të Kosovës është në Prishtinë.



Neni 6.

Simboli i Federatës Atletike të Kosovës përbëhet prej rrethit në formë elipse i cili simbolizon shtegun e atletikës dhe shkurtesës së federatës – FAK, me ngjyrë të kaltër të mbyllët dhe të bardhë, ndërsa shkronja A simbolizon vrapuesin.

Flamuri i Federatës Atletike të Kosovës ka formën e katërkëndëshit, me dimensione 1 x 2 m, ngjyrë të bardhë me simbolin e Federatës Atletike të Kosovës në mes.

Neni 7.

Vula e Federatës atletike është e formës rrethore, me përmasa 38 mm. Në rrethin e vulës është gdhendur (shkruar): Federata Atletike e Kosovës - Prishtinë, Kosovo Athletic Federation, ndërsa në mesin e vulës është simboli i vrapuesit.

Vula protokollare është e formës së drejtkëndëshit e madhësisë 65 x 22 mm, me tekstin e shënuar Federata Atletike e Kosovës – Kosovo Athletic Federation, dhe ka hapsirëm për shënimin e numrit dhe datës.

Neni 8.

Federata Atletike e Kosovës është person juridik, e regjistruar në regjistrin e organizatave sportive në autoritetin kompetent të shtetit.

Federata Atletike e Kosovës operon me llogari bankare dhe për të gjitha detyrimet, përgjigjet me mjetet e saj.

Federatën Atletike të Kosovës e përfaqëson Kryetari i FAK ose personi i autorizuar nga kryetari.

QËLLIMET DHE DETYRAT E FAK-ut

Neni 9.

Federata Atletike e Kosovës bashkëpunon me klubet atletike, organizatat tjera sportive lokale, rajonale apo ndërkombëtare, për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Neni 9.1.

Qëllimet e Federatës Atletike të Kosovës janë:

- Afirmimin dhe promovimin e atletikës në Kosovë,
- Përcaktimin e parimeve themelore dhe drejtimin e zhvillimit të atletikës,
- Koordinimin e veprimeve të përbashkëta në masivizim, zhvillim dhe përparimit kualitativ të sportit të atletikës.
- Inkurajimi i krijimit të klubeve të reja të atletikës,
- Mbështetje në organizimin e shkollave të atletikës, masivizimin dhe zhvillimin e atletikës në shkolla dhe ligave të atletikës për pionier, në nivel komunal, republikan dhe më gjerë,
- Vendosja e standardeve të garave republikane në atletikë dhe duke mbajtur kampionate republikane për të gjitha kategoritë,
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në hartimin e Programit Kombëtar të Sportit.
- Sigurojë fonde për aktivitetet e sportit të atletikës,
- Parandalimin e përdorimit të substancave të ndaluara në sport,



- Implementimin e standardeve ndërkombetare dhe kombetare në atletikë,

Neni 9.2.

Detyrat e Federatës Atletike të Kosovës janë:

- Miratimin dhe zbatimin e plan programit afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvillimit të atletikës.
- Ofron ndihmë në përgatitjen e atletëve për të arritur rezultate të larta dhe pjesëmarrje në krijimin e kategorive sportive.
- Përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve të organizatave sportive ndërkombëtare, donacioneve dhe ndihmave tjera nga vendi dhe jashtë vendit.
- Organizimi dhe pjesëmarrja e ekipit kombëtar të Kosovës, klubeve dhe individëve në garat ndërkombëtare dhe të tjera.
- Organizimin e aktiviteteve profesionale (gara sportive, kampe, seminare, diskutimeve profesionale, botime etj.) të karakterit lokal, regjional dhe ndërkombëtar.
- Afirmimi i sportit të atletikës,
- Hulumtimi dhe gjenerimi i fondeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tereneve të atletikës,
- Mbledh dhe arkivon dokumentacionin zyrtar dhe të aktiviteteve të atletikës, mirëmban literaturën historike,
- Inkurajon veprimtari botuese në fushën e atletikës dhe promovon atletikën.
- Inkurajon trajnimin e personelit profesional të atletikës (trajnerëve, gjyqtarëve dhe personave të tjerë puna e të cilëve është e rëndësishme për aktivitetet e atletikës).
- Kryerjen edhe të punëve tjera të përbashkëta në interes të zhvillimit të atletikës, në përputhje me Ligjin.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONEVE TJERA

Neni 10.

Federata Atletike e Kosovës bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë të pavarur, për realizimin e qëllimeve, detyrave dhe interesave të përbashkëta.

ANËTARSIMI

Neni 11.

Anëtarësimi në Federatën Atletike të Kosovës arrihet duke përmbushur kërkesat e ligjit, të këtij Statuti dhe rregulloreve në fuqi.

Sekretari pranon dhe përgaditë dosjen e klubit të ri për rexhistrim, aprovimin e bie kryesisht për pranimin e përkohshëm të antarit deri në kuvend. Kuvendi si organi më i lartë bie vendimin final për pranimin e antarit me të drejta të plota.



ANTARËT E FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

Neni 12.

Me statusin e anëtarit të FAK-ut në mënyrë të përafërt rregullohen: detyrat e anëtarit, përfaqësimi, pjesëmarrja, transparenca, mënyra e sigurimit të burimeve financiare, mbrojtja shëndetësore për atletët, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve, kushtet për hyrje në klub, masat anti-doping, përgjegjësitë disiplinore dhe materiale të anëtarëve, dhe çështjet të cilat janë me rëndësi për punë dhe veprim të anëtarit.

Anëtarët janë të obliguar që për çdo periudhë vjetore të e dorëzojnë në FAK raportet e punës dhe raportin financiar për aktivitetet e tyre.

Anëtarët e Federatës atletike detyrimisht duhet të kenë statutet e tyre në përputhje me ligjin Nr. 04/L-57 dhe këtë Statut dhe do të veprojnë në përputhje me aktet ligjore dhe organeve të Federatës.

Neni 13.

Personat juridik dhe fizik të cilët nuk janë anëtarë të FAK-ut mund të marrin pjesë në gara vendore, përveç në garat e kampionatit dhe kupave të organizuara nga FAK-u. Kurse, individët jo-anëtare mund të jenë përfaqësues të reprezentacionit të FAK-ut.

Organizimi i garave atletike dhe ngjarjeve të tjera në fushën e atletikës në Kosovë duhet të jenë në përputhje me ligjin për sport dhe këtë Statut, si dhe në bazë të vendimit të organit kompetent apo kryesisë së FAK.

TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE

Neni 14.

Anëtarët e Federatës Atletike të Kosovës do të ushtrojnë të drejtat, kryejnë detyrat dhe janë përgjegjës për arritjen e qëllimeve të caktuara në përputhje me Ligjin dhe këtë statut.

Neni 15.

Të drejtat e anëtarëve të FAK-ut janë:

- Hartimi i masave dhe zbatimi i qëllimeve dhe detyrave të cilat janë në funksion të zhvillimit të atletikës në Kosovë, në përputhje me politikën e themeluar në këtë fushë.
- Të marrin pjesë aktivisht në punën, në organet vendim-marrëse dhe trupat punues të FAK,
- Bazuar në statutin e FAK, të marrin pjesë në krijimin e të gjitha organeve të FAK.
- Të marrin pjesë aktive në krijimin e planeve dhe programeve të punës së FAK,
- Të kenë njohuri mbi punën e FAK-ut, të propozojnë dhe të marrin masa për arritjen e qëllimeve, detyrave dhe programeve të FAK,
- Të marrin pjesë në veprimtari profesionale dhe aktivitete tjera të FAK dhe të japin kontributin profesional të tyre,
- Të promovojnë dhe punojnë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Neni 16.

Obligimet e anëtarëve të FAK-ut janë:

- Të punojnë së bashku për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me këtë Statut, aktet tjera të FAK-ut dhe vendimet e FAK,



- Të marrin pjesë aktive në sigurimin e realizimit të planeve dhe programeve të miratuara të Federatës dhe obligime tjera me interes për sportin e atletikës në përgjithësi,
- Të punojnë, veprojnë dhe zbatojnë të gjitha rregullorët, vendimet, rekomandimet dhe konkluzionet e FAK,
- Të marrin pjesë në aktivitetet profesionale të FAK,
- Që të zhvillojnë frymën e tyre sportive dhe vlerat morale tek atletët dhe klubet e tyre,
- Të aplikojnë dhe të respektojnë kodin e sjelljes të anëtarit të FAK.
- Të mbrojnë të drejtat dhe interesat e FAK, reputacionin e Kosovës dhe të sportit të atletikës.

Neni 17.

Mandati i anëtarësisë së anëtarit të FAK-ut ndërpritet:

1. Me ndërprerjen e punës së anëtarit,
2. Në bazë të kërkesës me shkrim të anëtarit,
3. Për mosplotësimin e kushteve të nenit 11 ose të vepruarit në kundërshtim me nenin 16 të këtij Statuti,
4. Për mospjesëmarrjen në asnjë garë në vitin kalendarik të organizuar nga FAK-u.

Vendimin për ndërprerjen e anëtarësisë për shkaqet e përcaktuara në këtë statut, e bie Kryesia e FAK-ut, për të cilën e informon organin kompetent qeveritar për sport, klubin dhe organet tjera.

Neni 18.

Me akte të veçanta të FAK-ut, rregullohen të gjitha çështjet që lidhen me bashkëpunimin dhe funksionimin me FAK, kalimi nga një klub në tjetrin apo në federatat tjera si dhe propozicionet për gara apo çështje të tjera mbi këtë bazë.

ATLETËT

Neni 19.

Atleti është person i regjistruar për të garuar për klub, në emër të cilit merr pjesë në gara dhe ka të drejtë pjesëmarrje për klubin përkatës të atletikës, vetëm siq është rregulluar me rregullore dhe propozicione.

Me atlet të nivelit të lartë mendohet për personin i cili në garat e atletikës ka arritur rezultate të larta, të bazuar në kategorizimin e sportistëve sipas rregullores në fuqi të miratuar nga MKRS-ja, në propozim të kryesisë së FAK-ut.

Rregulloret për garat e atletikës në bazë të propozicioneve dhe akteve përkatëse të FAK-ut në mënyrë të obligueshme duhet të përfshihen në dispozitat mbi të drejtën për pjesëmarrje në gara.

Neni 20.

Atletëve u ndalohet përdorimi i mjeteve stimulative të palejuara, dhe në garat sportive mund të marrin pjesë personat që janë të shëndetshëm dhe të aftë për garat përkatëse, të dëshmuar në lejen garuese të atletit ku është vërtetuar gjendja shëndetësore, për të cilën bartë përgjegjësi klubi i cili e ka paraqitur për gara.

Pasqyra shëndetësore e atletit duhet të vërtetohet çdo gjashtë muaj.

Neni 21.



Me trajner të atletikës dhe punonjësit e tjerë profesional në sportin e atletikës mendohen personat të cilët janë të përfshirë në veprimtari sportive-garuese të klubeve të atletikës dhe kanë kualifikime adekuate profesionale, etike dhe morale për të kryer detyrën e trajnerit të atletikës. Trajnerët e atletikës duhet të pajisen me licencë përkatëse nga FAK-u.

Neni 22.

Gjyqtar i atletikës nënkuptohet personi që ka fituar titullin e gjyqtarit me dhënien e provimit dhe marrjen e licencës të lëshuar nga FAK-u ose IAAF.

Në kryerjen e funksioneve të tij, gjyqtari i atletikës është i pavarur dhe gjykon në bazë të rregullave dhe standardeve për gara atletike. Gjykimi në gara organizohet dhe kryhet në përputhje me rregullat dhe propozicionet e garave të atletikës në varësi nga niveli dhe lloji i garës.

ORGANET E FEDERATËS ATLETIKE

1. KUVENDI
2. KRYESIA
3. KRYETARI
4. KESHILLI MBIKQYRES

KUVENDI

Neni 23

Kuvendi është organi më i lartë i Federatës Atletike të Kosovës, i cili përbëhet prej delegatëve të deleguar nga kryesitë e klubeve antare. Kuvendi në mënyrë transparente planifikon, shqyrton dhe vlerëson aktivitetet dhe zhvillimin e sportit të atletikës në mes të dy seancave.

Neni 24.

Kuvendi mblidhet:

- ✓ së paku një herë në vit,
- ✓ kur mbledhjen e Kuvendit të jashtzakonshëm apo të rregullt e kërkon kryetari,
- ✓ kur këtë e kërkon Kryesia me 2/3 e votave të antarve të kryesisë,
- ✓ kur këtë e kërkon të paktën 1/2+1 e delegatëve me të drejtë vote,

Seanca e Kuvendit thirret së paku shtatë ditë para ditës të mbajtjes së saj, duke i njoftuar për rendin e ditës, dërgimin e materialeve të propozuara sipas rendit të ditës dhe duke specifikuar kohën dhe vendin e mbajtjes.

Nëse seanca e Kuvendit nuk mbahet pas thirrjes së tretë radhazi, Kryesia është përgjegjëse që të organizojë dhe të përgatisë një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Neni 25.

Klubet e licencuara nga FAK sipas rregullores për licencimit të klubeve kanë të drejtë pjesëmarrje në kuvend me nga 2 delegatë, ndërsa klubet e palicencuara marrin pjesë në kuvend vetëm cilësinë e vëzhguesit me vetëm një delegat.



Numri i përgjithshëm i delegatëve të kuvendit të FAK-ut varet nga numri i klubeve të cilat marrin licencë për çdo vit.

Delegat në Kuvend mund të jetë personi i cili është shtetas i Kosovës, të jetë i moshës madhore.

Delegatët e Kuvendit janë përgjegjës për përfaqësimin në Kuvend të klubit prej të cilit janë deleguar në Kuvend. Nëse një anëtar i Kuvendit nuk i përmbush detyrimet e tij sipas akteve të Federatës mund të shkarkohet në propozim të Kryesisë ose organizatës sportive që e ka deleguar, me procedurë dhe në mënyrën e përcaktuar për zgjedhjen dhe shkarkimin e delegatëve të Kuvendit. Një delegat i cili mungon pa arsye më shumë se tre herë, do të kërkohet shkarkimi i tij.

Neni 26.

Kuvendi i Federatës Atletikës të Kosovës është kompetent dhe përgjegjës për:

- ndryshimin e Statutit me 2/3 e votave,
- zgjedh kryetarin e FAK-ut me 1/2 e votave,
- zhgjedh kryesin (antarët që zgjidhen nga kuvendi) dhe këshillin mbikqyrës (3 antarë). Të deleguarit që marrin më së shumti vota zgjedhen në kryesi dhe këshill mbikqyrës.
- shqyrtimin e mocionit të mosbesimit të kryetarit dhe kryesisë së FAK-ut, me 2/3 e votave,
- shuarjen e FAK-ut,
- shqyrton planet dhe programet (vjetore, afatmesme (katër vjeqare) dhe afatgjate (tetë vjeqare) për zhvillimin e Federatës Atletike të Kosovës dhe udhëzimet për punën e organeve të FAK,
- shqyrton raportet e Kryesisë dhe Këshillit Mbikqyrës dhe vendos për ato,
- verifikon mandatin e anëtarëve,
- shkarkon kryetarin e FAK-ut, antarë të kryesisë dhe Këshillin mbikqyrës me 2/3 e votave,
- miraton rregulloret dhe aktet tjera me shumicë të thjeshtë të votave,
- kryen detyra të tjera në përputhje me ligjin dhe Statutin.

Neni 27.

Kuvendi mund të diskutojë dhe të marr vendime nëse ka kuorum i cili sigurohet me (1/2+1) e anëtarëve të tij. Vendimet merren me votim të hapur, me shumicën e thjeshtë (1/2+1) të votave të anëtarëve prezent, nëse nga shumica e delegatëve nuk kërkohet ndryshe.

Kryetari kryeson mbledhjet e Kuvendit të FAK-ut, kurse në mungesë apo pamundësi të tij një person i autorizuar prej tij.

Puna e Kuvendit dhe qeshje të tjera të cilat janë me rëndësi për punën e saj rregullohen me rregulloren e Kuvendit.

KRYESIA

Neni 28.

Kryesia është organ operativ dhe ekzekutues i FAK-ut, zbaton politikat në bazë të ligjit të sportit, këtij statuti, udhëzimeve dhe akteve tjera të Kuvendit, në mes të dy seancave të Kuvendit.

Kryesia FAK-ut përbëhet nga të paktën 11 antarëvë (7 antarë të zgjedhur nga kuvendi ku njëri duhet të jetë i gjinisë femërore dhe 3 të propozuar nga kryetari ndërsa kryesia e miraton ku njëri duhet të jetë i gjinisë femërore) me mandat prej 4 vjetësh. Antarët e kryesisë mund të rizgjedhen.

Neni 29.



Kryesia i FAK-ut përveç detyrave të mësipërme:

- propozon ndryshimet në statut të FAK-ut dhe akteve e përgjithshme të miratuara nga FAK-ut dhe Kuvendi i FAK.
- pregadit planin e punës dhe planin financiar të FAK-ut,
- propozon themelimin e ndërmarrjeve, organeve apo agjensive me rëndësi për FAK-un dhe anëtarët e FAK-ut,
- miraton aktet normative të FAK-ut dhe vendimet të cilat nuk janë në kompetencat e Kuvendit të FAK-ut,
- harton programe sportive për bashkëpunimi ndërkombëtar,
- miraton kalendarin, dhe shpërblimet në garat atletike të FAK,
- kandidatët për zgjedhje në organet e organizatave ndërkombëtare atletike;
- vendos si organ i shkallës së dytë për ankesa kundër vendimeve të shkallës së parë të komisioneve të FAK-ut;
- verifikon rekordet atletike të Kosovës,
- ndan mirënjohje dhe çmimet e FAK-ut,
- kryen edhe punë tjera nga veprimtaria e FAK-ut të cilat nuk janë nën juridiksionin e Kuvendit të FAK-ut.

Për kryerjen e aktiviteteve të caktuara brenda juridiksionit të saj kryesia mund të formojë komisione dhe trupa punues. Vendimi për ngritjen e komisioneve dhe përbërjes së saj.

Përfaqësuesit e Komisioneve mund të marrin pjesë në mbledhje të Kryesisë të FAK-ut, pa të drejtë vote, kur në rendin e ditës ka çështje nga kompetencat e tyre (me ftesë të kryetarit).

Neni 30.

Kryesia e FAK-ut përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve 7 i zgjedhë kuvendi dhe me kusht që një të jetë i gjinisë femrore, ndërsa 3 i zgjedh kryetari dhe me kusht që një të jetë nga gjinia femrore.

Kryesia mund të mbaj mbledhje nëse ka kuorum i cili sigurohet me $\frac{1}{2} + 1$ e antarve të kryesisë, kurse vendimet i merr me shumicë të thjeshtë $\frac{1}{2} + 1$ votë.

Antarët e kryesisë janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje. Nëse një antar i kryesisë nuk merrë pjesë në 3 apo më shumë mbledhje, pa arsye, vetvetiu shkarkohet dhe për plotsimin e tij përdoret renditja e votave të marra në kuvend. Ndërsa për antarët e kryesisë të zgjedhur nga kryetarit, zgjedhet nga kryetari.

Neni 31.

Seancat e Kryesisë i thirrë kryetari sipas nevojës, ndërsa rendin e ditës e harton në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm të FAK.

Në raste të jashtzakonshme kryetari e ka obligim të thërras mbledhjen e Kryesisë me kërkesën e së paku $\frac{1}{2}$ të anëtarëve të Kryesisë.

KRYETARI

Neni 32.

Kryetari i Federatës Atletike të Kosovës, në përputhje me Ligjin dhe statutin:

- përfaqëson dhe prezanton FAK-un,
- thërret mbledhjet dhe udhëheqë punën e Kryesisë së FAK-ut,



- kryeson Kuvendin,
- kujdeset për realizimin e politikave dhe detyrave me anëtarët e tjerë të Kryesisë së FAK, të cilat mund të jenë përgjegjës në mënyrë individuale për punë të caktuara në fusha të ndryshme të atletikës të deleguara paraprakisht nga kryetari,
- emëron dhe shkarkon përfaqësuesit e FAK-ut në organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare,

Kryetarin dhe Kryesinë e FAK-ut e zgjedh Kuvendi. Nga përbërja e Kryesisë, kryetari do të emron dy nënkryetar.

Neni 33.

Kryesia me shumicë të thjeshtë të votave (1/2+1) emëron dhe shkarkon anëtarët e komisioneve dhe organeve tjera, si më poshtë:

- Këshillin profesional për zhvillimin e atletikës nga 5 anëtarë,
- Selektorët për tri kategori i propozon kryetari ndërsa kryesia i miraton,
- Komisionin shëndetësore prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e marketingut prej 3 anëtarëve,
- Komisionin disiplinor prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e garave prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e regjistrimit prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e gjyqtarëve prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e trajnerëve prej 3 anëtarëve,
- Komisionin e veteranëve prej 3 anëtarëve,
- Dhe organet e tjera të punës, sipas nevojës.

Me vendimin për themelimin e Komisionit dhe organeve të tjera punuese përcaktohen detyrat dhe mënyra e punës sipas rregulloreve përkatëse të aprovuara nga Kryesia. Përveç anëtarëve të Kuvendit në përbërjen e komisioneve apo organeve tjera punuese mund të emërohen edhe punëtor të tjerë të atletikës, me kusht që një person mund të jetë anëtar më së shumti i dy komisioneve apo organeve tjera.

Punën e komisioneve dhe organeve tjera punuese e koordinon sekretari i përgjithshëm i FAK, nëse në vendimin për krijimin e organit nuk është thënë ndryshe.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 34.

Këshilli Mbikëqyrës kryen kontroll të organeve menaxhuese dhe egzekutive për ligjshmërinë e veprimit, mbikëqyr dhe analizon bilancin e FAK, kontrollon përdorimin e fondeve, shqyrton ligjshmërinë e procedurave të punës dhe vendimmarrëse.

Këshilli Mbikëqyrës zgjedhet nga Kuvendi dhe i raporton kryetarit për punën e tij dhe në Kuvend paraqet raport për të gjithë periudhën ndërmjet dy Kuvendeve, sipas përgjegjësisë dhe kompetencave të dhëna.

Neni 35.



Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, me mandat katër vjeçar, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Kuvendi të njëjtit i shkarkon në rast të konstatimit të parregullsive apo paaftësisë për të vepruar.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 36.

Për të kryer punë profesionale dhe administrativo-teknike kryesia zgjedhë sekretarin e përgjithshëm bazuar në ligjin për përzgjedhjen e aplikatëve për pozita të larta menaxhese.

Sekretari i përgjithshëm zgjedhet me konkurs publik për mandat katër (4) vjeçar. Sekretari i përgjithshëm mund të rizgjidhet në këtë pozitë.

Sekretarin e përgjithshëm e zgjedh komisioni i emëruar nga kryetari dhe i miratuar nga kryesia. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Rekomandohet që dy anëtarë të komisionit të jenë anëtarë të kryesisë, dy nga strukturat tjera të FAK dhe një profesionist i jashtëm.

Komisioni i propozon 3 konkurrentët më të mirë krytarit ndërsa kryetari e përzgjedh njërin nga të tre për pozitën e sekretarit të përgjithshëm.

Për punën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i kryetarit dhe në mënyrë periodike gjashtë mujore i raporton kryesisë.

Neni 37.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike duhet të jetë në marrëdhënjë pune të rregullt me FAK. Nëse rrethanat e kërkojnë ndryshë, atherë sekretari i përgjithshëm në negociim me kryetarin mund të vendosin për forma të tjera të angazhimit. Vendimin për këtë, si dhe çështje të tjera që lidhen me sekretarin e përgjithshëm i miraton kryesia. Për marrëdhënjen e punës ndërmjet sekretarit të përgjithshëm dhe FAK, duhet të vendoset konform ligjeve në fuqi të republikës së Kosovës.

Sekretari i Përgjithshëm i cili nuk është në marrëdhënjë të rregullt të punës nga Federata Atletike e Kosovës, vendosen tarifa për shpërblimin e punës së tij. Tarifat vendosen nga një komision i veçantë i emruar nga kryetari.

Nëse shihet e nevojshme, FAK mund të rekrutoj staf tjetër. Sekretari nxjerr vendim për rekrutim, të cilin e aprovon kryetari.

Neni 38.

Sekretari i Përgjithshëm i FAK është përgjegjës për:

- Përfaqësonimin e FAK në kuadër të kompetencave të tij dhe në harmoni me kryetarin dhe dokumentet tjera planifikuese, ligjore dhe strategjike të FAK,
- Përgatitjen dhe zbatimin e planit financiar në përputhje me këtë Statut,
- Kryen veprimtari në përputhje me vendimet përkatëse, konkluzionet dhe masat e Kuvendit dhe të Kryesisë,
- Përgatit dhe merrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit, Kryesisë dhe takimet tjera zyrtare në kompetencat e FAK,



- Është përgjegjës në menaxhimin dhe administrimin e të gjitha punëve të FAK,
- Është përgjegjës për shfrytëzimin ligjor të vulave të Federatës Atletike dhe ruajtjen e tyre,
- Është përgjegjës për pronën dhe ligjshmërinë e punës së Federatës Atletike,
- Kryen detyra të tjera të cilat ia ka besuar Kryesia e Federatës,
- I përgjigjet kryetarit në baza të rregullta dhe kryesisë në periudha 6 mujore apo edhe më shpesh nëse një gjë të tillë e kërkon kryesia.
- Zbatimin e detyrave nga paragrafi 1. i kryen në harmoni me kryetarin e FAK.

Neni 39

Sekretarin teknik e propozon kryetari ndërsa kryesia e miraton.

Kompetencat dhe detyrat e sekretarit teknik rregullohen me vendim të veçant.

PËRFAQËSUESJA ATLETIKE E KOSOVËS

Neni 40.

Për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare formohet përfaqësuesja e Kosovës në kategori të ndryshme. Komisioni përzgjedhës do të përcaktojë përbërjen e të gjithë ekipit.

Komisioni përzgjedhës zgjedhet sipas rregullore të veçant. E njejta rregullore e përcakton edhe përzgjedhjen e përfaqësueses.

Neni 41.

Federata Atletike e Kosovës, kryen kontrollin e dopingut sipas IAAF-së në garë dhe jashtë garës, në varësi të nevojave.

Lejon IAAF-në apo institucioneve të autorizuara të bëjë kontrollin e dopingut në kampionatin kombëtar dhe garat tjera që i zgjedhë, i mundëson dhe i organizon..

Neni 42.

Federata Atletike e Kosovës u lejon atletëve e tyre që të përdorin shërbimet e autorizuara agjent - menaxher në përputhje me rregullat e IAAF-së.

Qështjet e tjera me rëndësi për reprezentacionin caktohen me rregulloren për punën e reprezentacionit.

ASETET DHE BURIMET E FINANCIMIT TË FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

Neni 43.

Federata Atletike e Kosovës menaxhon pronat dhe pasuritë të cilat i posedon apo u janë dhënë në përdorim.



Në bazë të udhëzimeve, programeve dhe planit vjetor të punës, të ardhurat dhe shpenzimet e federatës atletike duhet të planifikohen në planin financiar.

Neni 44.

Pasqyra financiare të FAK përpilohen një herë në vit, sipas ligjeve në fuqi, nëse Kuvendi nuk kërkon raporte të tjera.

Fondet e Federatës Atletike mund të përdoren me qëllim të veçantë dhe në përputhje me programin e punës dhe planin financiar të Federatës Atletike të Kosovës.

Menaxhimi financiar dhe material është i organizuar dhe kryhet në përputhje me Ligjin dhe rregulloret tjera që kanë të bëjnë me këtë çështje, kurse këto punë i kryen personi i kualifikuar.

Të autorizuar për dokumentet financiare janë Kryetari, dhe sekretari i përgjithshëm i FAK.

Neni 45.

Për realizimin e detyrave FAK gjeneron mjete financiare, materiale dhe të drejtat tjera:

- nga kontributet e anëtarëve të saj,
- nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe qeveritë lokale,
- organizimi i ngjarjeve atletike,
- nga transmetimet televizive të ngjarjeve atletike,
- donacionet, grantet, dhurata, dhurimet, trashëgimitë, sponsorët, lokal dhe ndërkombëtar, si dhe reklamat, dividendët mbi fondet e investuara,
- nga kryerja e veprimtarive në përputhje me Statutin dhe ligjet në fuqi,
- nga burime tjera.

TRANSPARENCA

Neni 46.

Transparenca e punës së Federatës Atletike të Kosovës dhe organeve të saj do të ushtrohen nga veprimi publik i organeve të Federatës Atletike, me informimin e rregullt të organizatave sportive, organizatave shtetërore, organeve sportive, shoqatave dhe asociacioneve mediale; përmes konferencave për shtyp, deklaratave publike dhe përmes pranisë së drejtpërdrejtë të përfaqësuesve në programet e mediave dhe mbledhjet e organeve të FAK.

SHPËRBLIMET, NDERIMET DHE MIRËNJOHJET

Neni 47.

Për punë të suksesshme dhe rezultate të shkëlqyera në përparimin dhe zhvillimin e sportit të atletikës, kryerja e detyrave me përgjegjësi në fushën e organizimit ose përparimit të sportit të atletikës dhe organizatës atletike, atletët, punëtorët e atletikës, trajnerët, gjyqtarët dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë mund të jenë të lavdëruar (falënderuar) dhe të shpërblehen sipas rregullores së shpërblimeve.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 48.



Ndaj anëtarëve të FAK, respektivisht individëve të cilët në punën e tyre shkelin dispozitat e Statutit dhe rregulloreve tjera që lidhen me punën e tyre apo nuk i përmbahen parimeve të përgjithshme të sportit, ndërmerren masa disiplinore konform rregullores në fuqi.

SHPËRBËRJA E FEDERATËS ATLETIKE

Neni 49.

Federata Atletike do të shpërbëhet kur këtë e vendos Kuvendi sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Vendimi për shpërbërjen e Federatës atletike nga paragrafit 1 këtij neni, e bie kuvendi me dy të tretat e numrit të përgjithshëm të gjithë delegatëve të kuvendit.

Në rast të shpërbërjes, prona e FAK i përket autoriteteteve përgjegjëse për sport.

MËNYRA E VENDIMEVE PËR NDRYSHIME TË STATUTIT

Neni 50.

Ndryshimet dhe plotësimet në statut bëhen me procedura dhe në mënyrën e përcaktuar për miratimin e tij.

Propozimin për ndryshim dhe plotësim të statutit mund të paraqiten nga kryetari, kryesia, dhe miratohet nga 2/3 e delegatëve të Kuvendit.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 51.

Aktet e përgjithshme të Federatës Atletike të Kosovës, dhe aktet e anëtarëve të Federatës - klubeve të atletikës duhet t'i harmonizojnë statutet e tyre me këtë statut brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 52.

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti përfundon zbatimi i statutit të Federatës Atletike të Kosovës i vitit 2016.

Neni 53.

Ky statut hyn në fuqi pas aprovimit të tij nga Kuvendi.

Në Prishtinë, 04.04.2018.

KRYETARI I FAK-ut

Halil Sylejmani



(nënshkrimi dhe vula)